



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obština-Municipality of Pristina
SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT



Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "FATOSI SHPK" të datës 30.03.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi (loto 1) - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-9661-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "FATOSI SHPK" të datës 30.03.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi (loto 1) - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-9661-2-1-1.
- II. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "FATOSI SHPK" (tutje "parashtruesi") me datë 30.03.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi (loto 1) - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-9661-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "AK këtu po paraqet informata jo reale duke shkelur plotësisht ligjin për financat publike dhe për buxhetin por edhe ligjin e prokurimit publik pasi që në rastet e tilla vet AK duhet ta bartë buxhetin në vitin vijues".

Parashtruesi po ashtu parashtron disa pretendime sipas të cilave edhe oferta e një tenderuesi tjetër është e papërgjegjshme.

Arsyetimi i dhënë nga ana juaj si AK për anulimin e aktivitetit, respektivisht mungesa e buxhetit të parashikuar, është i pabazuar dhe jo bindës për arsyet në vijim: Aktiviteti i prokurimit është iniciuar me vlerë të parashikuar prej 150,000.00 €, çka nënkupton se planifikimi buxhetor ka ekzistuar në momentin e publikimit, për më tepër, theksojmë se aktiviteti i prokurimit është zhvilluar si kontratë publike kornizë me kohëzgjatje 24 muaj dhe me formë ekzekutimi përmes thirrjeve/porosive.

Kjo nënkupton qartë se realizimi i kontratës nuk kërkon sigurimin e menjëhershëm të buxhetit të plotë, por financimi bëhet në mënyrë graduale në faza, në përputhje me nevojat dhe porositë e Autoritetit Kontraktues.

Sipas vendimit të AK, aktiviteti i prokurimit është anuluar për arsyet si në vijim: “në mungesë të mjeteve buxhetore për vitin 2026”.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se vendimi i AK për anulimin e aktiviteti të prokurimit janë në përputhje të plotë me nenin 62 të LPP lidhur me nenin 43 të RRPP. Rrjedhimisht është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën II dhe III të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 03.04.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.